



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE PRONAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 02, datë, 22.01.2024

**“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË,
SIPAS STRUKTURAVE TË APARTAMENTEVE”**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit në mbledhjen e Këshilit Bashkiak të datës, ____ .01.2024

PROPOZON

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare të apartamenteve në treg, për efekt subvencionimi të qirasë:

a) Për apartament të tipit “Garsonierë”	6,000	lekë/muaj
b) Për apartament të tipit 1+1	12,000 – 15,000	lekë/muaj
c) Për apartament të tipit 2+1	15,000 – 18,000	lekë/muaj
d) Për apartament të tipit 3+1	18,000 – 22,000	lekë/muaj

- Miratimin e vlerës të qirasë vjetore për vitin 2024, për apartamentet e programit “Banesë sociale me qira”, me vlerën 88 lekë/m² në muaj;
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit, Bashkia Dibër;
- Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e institucionit të Prefektit, Qarku Dibër;

**Përgjegjës i Sektori të
Administrimit të Pronave
dhe Strehimit**
Gazmend Miftari



Drejtori Juridik

Ismet Saraçi

Date _____._____.2024

**RELACION
PER PROJEKT VENDIMIN
PËR**

**“ MIRATIMIN E NIVELIT TE QIRASE MESATARE NE TREG TE LIRE SIPAS
STRUKTURAVE TE APARTAMENTIT ”**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM Nr. 362_date 29.05.2019_Per kriteret e dhenies se subvencionit te qirase per kategorite qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, ky projekt vendim bazohet ne nenin 73 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, pik 2 germa (dh) ku citohet : Brenda muajit janar të çdo viti, njesia vendore paraqet pranë ministrit përgjegjës për strehimin kërkesën për financime, investime dhe subvencione, sipas këtij ligji, nga fondet e buxhetit të vitit korrent, shoqëruar me informacionin, i cili përmban:

- numrin e familjeve të regjistruara për t’u trajtuar me programet sociale të strehimit;
- numrin e familjeve që janë trajtuar brenda një viti;
- nivelin e qirasë së miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Punoi:

Specialist strehimi Mentor Bitri



Juriste. Xhesika Rama



Pranoi :

P/ Sektorit te Pronave dhe Strehimit

Gazmend Miftari

